



Datë: 10.09.2020

Konform nenit 91 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenit 6, pika 5 e Rregullores së Punës së KRPP-së, duke u bazuar në Ligjin Nr. 02/L-109 për Parandalimin e Sëmundjeve Ngjithëse, si dhe duke u bazuar në Vendimet e Qeverisë, Nr. 01/13 dhe Nr. 04/13 të dt. 13.07.2020, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e dispozitave 56.10 dhe 56.11 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, nxjerrë këtë:

NJOFTIM

Situata epidemiologjike në vend, ka ndryshuar krahasuar me situatën paraprake e konstatuar nga IKSHPK dhe zyra e OBSH-së në Kosovë. Në ditët e fundit ka rritje të rasteve të prekura me COCID-19 dhe kjo mund të shpie në përhapje masive të virusit që do të rrezikonte seriozisht shëndetin publik me pasoja të rënda për shëndetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Prandaj, duke u bazuar në Vendimet e Qeverisë Nr. 01/13 dhe Nr. 04/13 të dt. 13.07.2020, sipas të cilave pothuajse të gjitha institucionet publike kryejnë funksionet e përcaktuara me ligjet përkatëse me staf minimal të reduktuar, njëjtë situata epidemiologjike ka ndikuar që edhe operatorët ekonomik t'i kryejnë obligimet kontraktuale me staf të reduktuar gjë që ka ndikuar që kontratat në ekzekutim, të mos mund të ekzekutohen në afatin e caktuar.

Bazuar në rrethanat e lartë përmendura, si dhe duke pas parasysh faktin se **Pandemia COCID-19** konsiderohet një rrethanë e **"Forcës madhore"** në kuptim të përkufizimit që është dhënë për "Forcën madhore" në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, KRPP i këshillon të gjitha autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik që në këtë situatë pandemie kanë në ekzekutim kontrata për furnizim, shërbime punë dhe si rezultat i pandemisë kanë hasë në vështirësi për t'i realizuar në kohë kontratat, të veprojnë në përputhje me kushtet e kontratës, për sa i përket, si në vijim:

Neni që ndërlidhët me **"Forcën madhore"** ndryshon në secilin lloj të kontratës. Me poshtë janë tri llojet e kontratave.

1. **Në rastin e kontratave për punë**, Operatori Ekonomik duhet të kërkon zgjatje të periudhës së ekzekutimit. Autoriteti Kontraktues në përputhje me rrethanat vlerëson kërkesën, dhe nëse e miraton **pezullohet për një periudhë të caktuar kontrata**. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, **Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës**.

Kjo do të thotë se nëse OE kërkon dhe AK e miraton, duhet të pezullohet kontrata për një periudhë të caktuar, e të vazhdohet sipas kushteve të kontratës pas pezullimit kur të plotësohen kushtet.

2. Në rastin e kontratave për furnizime, OE duhet të kërkon zgjatje të periudhës së ekzekutimit. AK në përputhje me rrethanat vlerëson kërkesën, dhe miraton zgjatjen e periudhës së ekzekutimit. Nëse OE nuk arrin të furnizoj autoritet Kontraktuese në afatin kohor shtese të miratuar nga AK-te atëherë autoriteti kontraktues mund ta ndërpres kontratën
3. Në rastin e kontratave për shërbime, OE duhet të kërkon zgjatje të periudhës së ekzekutimit. AK në përputhje me rrethanat vlerëson kërkesën, dhe miraton zgjatjen e periudhës së ekzekutimit. Nëse si **rezultat i Forcës Madhore**, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë, **Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën.**

Kjo do të thotë se nëse OE kërkon dhe AK e miraton, i lejohet shtyrja e afatit për një periudhë të caktuar.

Në rast se vjen deri te ndërprerja e kontratës (furnizim, shërbime, punë) si rezultat i forcës madhore, Siguria e Ekzekutimit nuk do të konfiskohet.

Po ashtu Dispozitat 56.10 dhe 56.11 të nenit 56 **“Kontratat publike Kornizë”** të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (ROUPP), e të cilat kërkojnë që:

*“56.10 Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është **vetëm sasi indikative**. Kurdo që Autoriteti kontraktues specifikon sasinë indikative, Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit **vlerën ose sasinë e kontratës** si një prag apo një tavan dhe do të lejohet devijimin prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se **plus/minus tridhjetë përqind (30%)**. Nëse urdhër blerjet tejkalojnë **sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative** të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht. Mospërputhja e lejuar **plus/minus tridhjetë përqind (30%)** vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar AK nuk mund të bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull.*

*56.11 Mospërputhja e lejuar konsiston në **plus/minus tridhjetë përqind (30%)** të pragut apo tavanit të sasive totale apo vlerës totale indikative të kontratës, mirëpo, **kjo nuk do të thotë që Operatori Ekonomik duhet të paguhet për punët, shërbimet apo furnizimet e pa porositura nga Autoriteti Kontraktues**. Sipas këtij kufizimi (+/-30%), Autoriteti Kontraktues merr përsipër që të porositë, pranoj dhe paguaj sasinë totale prej së paku shtatëdhjetë përqind (70%) nga sasia indikative e vendosur në dosjen e tenderit përkatësisht në kontrate, prandaj autoritetet kontraktuese duhet të kenë parasysh këtë fakt sidomos në fazën e përgatitjes së sasive indikative në dosje të tenderit e cila në secilin rast nuk guxon të ndryshojë në plus/minus 30 % e vlerës indikative.*

Ne situatat e cekura me larte AK-të mund të shtojnë sasitë e specifikuara në kontratat në fuqi (kontratat publike Kornize) , qoftë edhe për pozicion për të gjithë artikujt/pozicionet për të cilët është shtuar nevoja e AK-ve që të bëjnë porositë e artikujve të tillë pavarësisht kufizimeve (+30 %) dhe/ose NUK obligohen të bëjnë porositë me qëllim të realizimit të 70% të sasive indikative të vendosura në Dosjen e Tenderit përkatësisht në Kontratë.

Bazuar në rrethanat e lartë përmendura, Autoritetet Kontraktuese dhe në mbështetje të neneve përkatëse me marrëveshje miqësore me OE të bëjnë AMANDAMENTIM të kontratave në fuqi duke i përshtatur ato me nevojat e aktuale si rezultat i situatës se “forcës madhore” dhe përmbushjes më të mirë të kontratave përkatëse (ndryshohen sasitë e parashikuara).

Në të gjitha këto raste AK duhet të luajnë një rol aktive në përcaktimin e kushteve të kontratës të cilat sigurojnë vlerën më të mirë për parane për autoritetin kontraktues Publik

Osman VISHAJ

Kryetar i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik

